



Proçesverbal i Takimit të 19-të të Grupit të Aktorëve për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

08 Qershor 2018, vendi i takimit Dorcas Aid Albania - Korçe, Republika e Shqipërisë



South Eastern Europe
SWG
Regional Rural Development Standing Working Group

ABD
PROGRAMME

PRESPA
CROSS-BORDER REGION



Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 19-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 24 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Stafi i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve kontaktet dhe detaje mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 19-të për rajonin “Prespa” 08.06.2018;

ANNEX 2: PPP_Seminari “Zhvillimi i Zhinxhirëve të Vlerës në Sektorin e Agrobiznesit”

ANNEX 3: PPP_Eventet “Njerëzit për Njerëzit” për Rajonin ndërkufitar Prespa;

ANNEX 4: PPP_Potencialet në turizëm për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike;

ANNEX5: PPP_Potencialet në agrobiznes për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike;

Programi i takimit:

Takimit i 19-të i Grupit të Aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

09:30 – 10:00 **Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes**

10:00 – 10:15 **Fjalimi i mirëseardhjes**

Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”

Z. Damjan Surlevski Projekt Menaxher SWG

Z. Darko Buzarovski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:15 – 10:40 **Përmbledhje e aktiviteteve të përgjithshme në lidhje me zbatimin e qasjes ABDA në rajonin ndërkufitar “Prespa” në kuadër të projekti të BE-së: “Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të zonave ndërkufitare”.**

- Prezantim dhe diskutim rreth iniciativave të grupeve të punës kluster/zinxhirit të vlerës dhe seminarit për ngritjen e kapaciteteve “Zhvillimi i Zhinxhirëve të Vlerës në Sektorin e Agrobiznesit”

Z. Darko Buzarovski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:40 – 11:00 **Diskutim rreth aktiviteteve të ardhshme në lidhje me zbatimin e veprimeve “Njerëzit për Njerëzit” për Rajonin ndërkufitar Prespa.**

- Hithra - Shkolla e vogël e gastronomisë
- Agrobiznesi, një sfidë e re për të rinjtë në rajon
- Tour de Galicica 2018
- Ditët e verës dhe djathit
- Njihu me Prespën
- Vera Kulturore Maqedonase 2018
- Sport dhe kulturë



South Eastern Europe
SWG
Regional Rural Development Standing Working Group

ABD
PROGRAMME



PRESPA
CROSS-BORDER REGION



The project is funded by the European Union

- Realiteti rural bëhet një vlerë përmes manifestimit "Vjelja e Mollës në Prespë"

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar "Prespa"

11:00 – 12:00 **Prezantimi i të dhënave të vlerësimit të potencialeve për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat ndërkufitare rurale përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës së shkurtër.**

*Znj. Suzana Dordevic – Milosevic, Experte Seniore - SWG
Z. Predrag Markovic, Expert Rajonal për bujqësinë – SWG
Z. Filip Sekuloski, Expert Rajonal për turizmin – SWG*

12:00 – 12:30 **Diskutim dhe konkluzionet e takimit**

12:30 – 13:30 **Dreka**

Proçesverbali i takimit

Takimi filloi me fjalën përshëndetëse të Menaxherit Rajonal për Rajonin Ndërkufitar "Prespa" Z. Darko Buzarovski, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe falenderoi Dorcas Aid Albania për mikëpritjen e takimit. Ai shprehi kënaqësinë duke konfirmuar intensifikimin e bashkëpunimit të mirë mes aktorëve në rajonin Prespa përmes organizimit të aktiviteteve të rrdyshme të përbashkëta.

Në emër të Dorcas Aid Albania, por gjithashtu edhe si Presidente e grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar të Prespës, Znj. Viola Bogdani përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për organizimin e takimit të 19-të të grupit të aktorëve Prespa në ambjentet e Dorcas Aid Albania – Korçe. Ajo theksoi rëndësinë e këtyre aktiviteteve në rajon duke shprehur bashkëpunimin e frutshëm dhe punën e bërë deri tani nga aktorët për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare.

Në vazhdim, Z. Vangjush Dishnica përshëndeti pjesëmarrësit dhe falenderoi për mikëpritjen e takimit të 19-të të grupit të aktorëve si edhe të gjithë pjesëmarrësit për prezencën e tyre duke uruar një bashkëpunim sa më të frutshëm mes aktorëve. Pas fjalës së mirëseardhjes, Menaxheri Rajonal për Rajonin Ndërkufitar "Prespa" Z. Darko Buzarovski, prezantoi programin e takimit duke u ndalur në secilën prej çështjeve për tu trajtuar.

Sesioni 1

Përmbledhje e aktiviteteve të përgjithshme në lidhje me zbatimin e qasjes ABDA në rajonin ndërkufitar "Prespa" në kuadër të projekti të BE-së: "Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të zonave ndërkufitare"

Seanca filloi me prezantimin e Z. Darko Buzarovski Menaxheri Rajonal për Rajonin Ndërkufitar "Prespa", i cili dha një përmbledhje të aktiviteteve të përgjithshme të organizuara gjatë dy mujorit të fundit në lidhje me zbatimin e qasjes ABDA mbështetur nga projekti i BE-së "Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të vendeve ndërkufitare". Gjithashtu, prezantimi u fokusua në përmbledhjen rreth iniciativave



South Eastern Europe
SWG
Regional Rural Development Standing Working Group

ABD
PROGRAMME



PRESPA
CROSS-BORDER REGION



The project is funded by the European Union

të grupeve të punës klister/zinxhirit të vlerës dhe seminarit për ngritjen e kapaciteteve “Zhvillimi i Zhinxhirëve të Vlerës në Sektorin e Agrobiznesit” për rajonin ndërkufitar Prespa. Në vazhdim, u prezantua dhe diskutua në lidhje me ecurinë dhe punën e realizuar deri tani nga dy grupet e punës të krijuara në prioritetet kryesore të bujqësisë dhe turizmit për zhvillimin e rajonit ndërkufitar Prespa.

Trajnimi mbi zinxhirit e vlerës për rajonin ndërkufitar Prespa u mbajt ne Hotel Lakeviw në Oteshevo, nga data 14 – 16 Maj 2018. Ky trajnim tre ditor u ndoq nga aktorë të rajonit ndërkufitar Prespa nga Maqedonia dhe Shqipëria, përfaqësues nga sektori publik – bashkitë dhe drejtoria e bujqësisë, sektori privat: prodhues të mollës, përpunues të frutave, prodhues të mjaltit, kooperativa të frutave si edhe sektorit civil- përfaqësues nga Grupi Lokal I Veprimt Prespa, organizata për gruan rurale etj.

Gjate kësaj seance konkluzione dhe rekomandime u prezantuan dhe diskutuan. Kështu, u theksua se zinxhirët e vlerës në agrobiznes dhe prodhimin e mollës, janë një drejtues ekonomik i rëndësishëm në të dy vendet, Maqedoni dhe Shqipëri. Gjithashu, u diskutua se zinxhiri i vlerës duhet të përmirësohet që të mbështesë agrobiznesin dhe prodhimin e mollës si sektor kryesor dhe të përmirësojë standartet e jetesës së popullsisë. Si konkluzion u theksua se Njësia e Menaxhimit të Projektit Prespa dhe SWG do të mbështesin këto iniciativa klaster në rajon dhe do të përpiqen të gjejnë fonde shtesë për mbështetjen financiare të aktiviteteve të ardhshme të dy grupeve të punës.

Sesioni 2

Diskutim rreth aktiviteteve të ardhshme në lidhje me zbatimin e veprimeve “Njerëzit për Njerëzit” për Rajonin ndërkufitar Prespa.

Prezantimi filloi me përmbledhjen e thirrjes Njerëzit për Njerëzit dhe veprimeve të ndërmarra gjatë kësaj periudhe në rajonin ndërkufitar Prespa. Gjatë prezantimit, u pasqyrua informacion i përgjithshëm rreth rezultateve të thirrjes se hapur për eventet Njerëzit për Njerëzit. Në total, për rajonin ndërkufitar Prespa, u dorëzuan njëmbëdhjetë (11) aplikime. Komisioni i vlerësimit, i mbajtur më 20 Shkurt 2018, rishikoi dhe vlerësoi të gjitha aplikimet sipas listës së pikëzimit dhe protokollit. Tetë (8) aplikime do të mbështeten për zbatim të mëtejshëm të aktiviteteve rajonale Njerëzit për Njerëzit në rajonin ndërkufitar Prespa dhe deri tani janë zbatuar dy (2) prej tyre.

Eventi i parë “Hithra - Shkolla e vogël e gastronomisë”, u mbajt ne fshatin Kuratica, ne Ohër në datat 02 dhe 03 Qershor 2018 dhe u organizua nga organizata për turizëm rural, ekologji dhe traditë - O.R.T.E.T, me të ftuar nga qyteti i Ohrit dhe Pogradecit, të cilët patën mundësinë të promovonin aktivitete turistike dhe shijonin produkte lokale tradicionale sipas recetave të bazuara në bimën e hithrës.

Gjithashtu, aktiviteti i dytë u zbatua nga Fakulteti i Bujqësisë i Universiteti “Fan.S.Noli” në Korçë, Shqipëri. Seminarin “Agrobiznesi, një sfidë për të rinjtë në rajon”, u mbajt më 07 Qershor 2018 me qëllim krijimin e një rrjeti fermerësh të rinj të motivuar për diskutimin e interesave dhe adresimin e sfidave të përbashkëta në bujqësi. Në vazhdim gjashtë (6) aktivitete të tjera Njerëzit për Njerëzit do të mbështeten në muajt në vazhdim:

- Tour de Galicica 2018; Një turne ciklizmi në malin Galicica me qëllim promovimin e natyrës dhe mundësive turistike të rajonit të Prespës, do të organizohet nga Komuna e Resnjës më 28 Gusht 2018.

- Ditët e rrushit dhe djathit; Një festival i verës, djathit dhe mjaltës organike nga prodhuesit lokalë kryesisht nga rajonet rurale të Prespës do të sjellin produktet e tyre dhe do t'i paraqesin ato direkt në treg. Aktiviteti do të organizohet nga Komuna e Ohrit në datat 10-11 Gusht 2018.



South Eastern Europe
SWG
Regional Rural Development Standing Working Group

ABD
PROGRAMME



PRESPA
CROSS-BORDER REGION



The project is funded by the European Union

- Takohu me Prespën; Eventi do të organizohet nga Shoqata e prodhuesve të mollëve Blagoj A. Kotlarovski - Fokus grupi i grave rurale nga Prespa në datat 31 Gusht - 02 shtator 2018. Qëllimi i këtij seminari është forcimi i bashkëpunimit rajonal midis organizatave të agroturizmit dhe turizmit në Prespë.

- Verë kulturore maqedonase 2018; Ngjarja kulturore do të organizohet nga Shoqata SONCE dhe do të mbahet në Pustec të Shqipërisë më 25-30 Korrik 2018.

- Sporti dhe kultura - e ardhmja e rajonit tonë; Aktivitetet sportive do të organizohen nga PE Biljani Izvori në Ohër, Maqedoni në datat 16-17 Qershor 2018.

- Ruraliteti bëhet një vlerë brenda manifestimit "Vjelja e Mollëve në Prespë"; Aktiviteti do të organizohet nga Grupi i Veprimtimit Lokal ZRR AGRO LEADER dhe është planifikuar si një ngjarje dy ditore në kuadër të Ditës tradicionale të vjeljes së mollëve në Prespës në data 26 dhe 27 Shtator 2018, në Resnjë, Maqedoni.

Sesioni 3

Prezantimi i potencialeve për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat ndërkufitare rurale përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës së shkurtër.

Seanca përfshiu prezantimin e Z. Predrag Markovic, Expert Rajonal për bujqësinë – SWG dhe Z. Filip Sekuloski, Expert Rajonal për turizmin – SWG, të cilët dhanë një përmbledhje të të potencialeve për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat ndërkufitare rurale përmes zhvillimit të zinxhirit të vlerës së shkurtër për rajonin e Prespës. Në përgjithësi u diskutua dhe sugjerua që aktorët në rajonin Prespa kanë nevojë për përmirësim me qëllim sigurimin e shërbimeve më të mira dhe të përmirësojnë zinxhirin e vlerës. Gjithashtu, mbështetja e agrobiznesit dhe agroturizmit nga donatorët në të ardhmen do të jetë e nevojshme për zhvillimin e rajonit ndërkufitar. Në vazhdim, pjesëmarrësit konkluduan se masa LEADER mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës në rajon dhe duhet të merret në konsideratë si një potencial për tërheqjen e fondeve në të ardhmen.

Sesioni 4

Konkluzionet dhe aktivitetet e ardhshme

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Njësia për menaxhimin e projektit "Prespa" dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informative ku antarët e grupit të marrin informacion të nevojshëm për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin në përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon dhe thirrje të tjera të aktive për rajonin;
- Pas procesit të vlerësimit për mbështetje financiare tetë (8) projekt aplikime do të mbështeten për zbatim të mëtejshëm të aktiviteteve rajonale Njerëzitet për Njerëzitet në rajonin ndërkufitar Prespa. Dy (2) aktivitete janë zbatuar deri tani dhe gjashtë (6) evente të tjera Njerëzitet për Njerëzitet do të mbështeten në muajt në vazhdim;
- U theksua se zinxhirët e vlerës në agrobiznes dhe prodhimin e mollës, janë një drejtues ekonomik i rëndësishëm në të dy vendet, Maqedoni dhe Shqipëri;



South Eastern Europe
SWG
Regional Rural Development Standing Working Group

ABD
PROGRAMME

PRESPA
CROSS-BORDER REGION



- Zinxhiri i vlerës duhet të përmirësohet që të mbështesë agrobiznesin dhe prodhimin e mollës si sektor kryesor dhe të përmirësojë standartet e jetesës së popullsisë dhe gjithashtu, aktorët në rajonin Prespa kanë nevojë për përmirësim me qëllim sigurimin e shërbimeve më të mira dhe të përmirësimin e zinxhirit të vlerës
- Njësia e Menaxhimit të Projektit Prespa (PMU) dhe SWG do të mbështesin këto iniciativa klaster në rajon dhe do të përpiqen të gjejnë fonde shtesë për mbështetjen financiare të aktiviteteve të ardhshme të dy grupeve të punës;
- Mbështetja e agrobiznesit dhe agroturizmit nga donatorët në të ardhmen do të jetë e nevojshme për zhvillimin e rajonit ndërkufitar Prespa;
- Masa LEADER mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës në rajon dhe duhet të merret në konsideratë si një potencial për tërheqjen e fondeve në të ardhmen.

Përgatitur nga:

Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

Darko Buzarovski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”